

DHJETOR 2022

KALENDARI ARTISITIK



“EDMOND”

82 skena. 35 personazhe. 13 aktorë.

Komedi nga Alexis Michalik

Data: 2,3, 4, , 9, 10 dhjetor, 2022

E martë - E diel 09:00-13:00 & 16:00-19:00

Vendi: Teatri Kombëtar, Arturbina, Salla 400

Regjia: Andia Xhunga dhe Indrit Çobani

Interpretojnë: Helidon Fino, Lulzim Zeqja, Vasian Lami, Laert Vasili, Genci Fuga, Flaura Kureta etj.

ORARI I BILETARISË:

TEL: 04 222 3022 | 068 2000 650

Çmimi i biletës:

500 lekë: E premte, e shtunë, e diel

300 lekë: E enjte

“HAPAT”

Festival Teator- Fondi i Teatrit Për të Rinj

Data: 30 nëntor – 13 dhjetor 2022

Vendi: Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”

Fondi i Teatrit Për të Rinj, iniciativë e Ministrisë së Kulturës në bashkëpunim me Teatrin Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli” ka mbërritur në fazën përfundimtare.

14 shfaqjet teatrore që u realizuan nga ky fond do të finalizohen me pjesëmarrjen në Festivalin Teator “HAPAT” që do të zhvillohet nga data 30 nëntor deri më 13 dhjetor.

Shfaqjet do të luhen në skenën e Teatrit Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”, Teatrit Metropol dhe Teatrit privat “Zonja e Bujtinës”.

Festivali ka natyrë kompetitive. Vlerësimet do të kryhen nga juria profesioniste e përbërë nga Aneta Malaj, Armela Demaj dhe Enke Fezollari. Çmimet që do të jepen janë:

- Shfaqja më e mirë
- Regjia më e mirë
- Aktori më i mirë
- Aktorja më e mirë

Programi i festivalit

30 nëntor – Koncerti – regjia Marsel Greva – TKE “Kujtim Spahivogli” – ora **19:00**

1 dhjetor – Panik – regjia Blendi Arifi – Teatri i Metropolit – ora **19:00**

2 dhjetor – Kam Frikë – regjia Semela Skënderasi– TKE “Kujtim Spahivogli” – ora **19:00**

3 dhjetor – Emigrantët – regjia Kriks Dumo - TKE “Kujtim Spahivogli” – ora **19:00**

4 dhjetor – Rini e Çmenduri – regjia Alba Shtëmbari - TKE “Kujtim Spahivogli” –



ora 19:00

5 dhjetor – Misto – regjia Franceska Hysi – Teatri Privat “Zonja e Bujtinës” – **ora 19:00**

6 dhjetor – Kolonel Zog – regjia Xhuljano Brisku - TKE “Kujtim Spahivogli” – **ora 19:00**

7 dhjetor – Pse nuk qëndron për mëngjes – regjia Dejvis Bejleri - TKE “Kujtim Spahivogli” – ora 19:00

8 dhjetor – Lojëra në oborrin e pasëm – regjia Kjara Gjergji - TKE “Kujtim Spahivogli” – **ora 19:00**

9 dhjetor – Elektroshok – regjia Sara Smaja - TKE “Kujtim Spahivogli” – **ora 19:00**

10 dhjetor – Muji dhe Halili – regjia Ina Morinaj - TKE “Kujtim Spahivogli” – **ora 19:00**

11 dhjetor – Madhështia e Marrëzisë – regjia Ajlin Petrela - TKE “Kujtim Spahivogli” – **ora 19:00**

12 dhjetor – Nina – regjia Marsel Rupi - TKE “Kujtim Spahivogli” – **ora 19:00**

13 dhjetor – Kjo rinia jonë – regjia Silvio Goskova - TKE “Kujtim Spahivogli” – **ora 19:00**



“KOLONELI ZOG”

Hristo Boytchev

Data: 2,3,4, dhjetor 2022

Ora: 19:00

Vendi: Teatri “Aleksandër Moisiu”

Regjisor Xhuliano Brisku

Interpretojnë: Florian Agalliu, Roerd Toçe, Franc Bregu, Donald Shehu, Urim Aliaj, Paolo Kadillari Artemis Beluli.

Videografia: Fabio Seferi

Koreografia: Robert Nuha

Kostumografia: Dhespina Cani & Lira Zahiri

Skenografia: Erti Bejdo

Në një manastir në malet e Ballkanit janë strehuar disa pacientë të harruar nga bota e përtejme, e kur një doktor vjen të inspektojë këtë spital ‘të marrësh’ për t’i rikthyer përsëri në normalitet, fillon dhe ai të vërë në mëdyshje vetë ekzistencën e tij duke u bërë pjesë e kësaj çmendurie. Koloneli dhe doktori pas shumë përpjekjesh arrijnë ta kthejnë në normalitet këtë vend me anë të disiplinës së rreptë ushtarake, por ëndrrat e tyre nuk mbarojnë me kaq, ato fluturojnë si një zog për të gjetur botën e lirë dhe të mbrojtur nga çdo luftë që mund t’i kanoset këtij manastiri.

Idealet për t’iu bashkuar një bote të mbrojtur dhe të civilizuar, do të bëjnë që ata të ndërmarrin një udhëtim të gjatë drejt Strasburgut, për t’u anëtarësuar në OKB.



“RRUGA E QUMËSHTIT”

Monodramë

Data: 07 dhjetor 2022

Ora: 11.00

Vendi: Në hollin e ndërtesës së Autoritetit, në adresën: Njësia Administrative nr 4, Rruga e Dibrës, garnizoni “Skënderbej”.

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit ka kënaqësinë t’ju ftojë në shfaqjen e monodramës “Rruga e qumështit” me regjisor Armando Borën dhe interpretim të aktore Eglë Ceno

Programi:

Ora 11:00 - Shfaqje e monodramës “Rruga e qumështit”;

Ora 12:00 - Fjala e Kryetares së Autoritetit, dr. Gentiana Sula;

- Fjala e regjisorit: Z. Armando Bora

“CERTIFIKATA E MARTESËS”

Data: 15, 18, 22-25 dhjetor 2022

Ora: 19.00

Vendi: Arturbina, salla e madhe 400

Shfaqje teatrore e autorit të mirënjohur izraelit Ephraim Kishon, e cila është mbështetur në përshtatjen në gjuhën shqipe nga Ambasada e Izraelit.

“PRIFTI”

Data: 21-24 dhjetor 2022

Ora: 19.00

Vendi: Arturbina

Shfaqje teatrore Teatri Rikthimi

Produksion privat, mbështetur nga Ministria e Kulturës

“ZHURMA E KOHËS”

Premierë

Data: 8, 9, 10, 11, 15, 16, 17, 18 dhjetor 2022

Ora: 19:00

Vendi: Teatri Metropol

Autor: Rafael Hoxhaj

Regjia: Rafael Hoxhaj

Interpretojnë: Rafael Hoxhaj

As.regjisor: Bujar Hoxhaj

Muzika: Rafael Marinaj

Kostumograf: Frenci Gjerasi

Vepra ka si personazh një aktor, i cili flet për jetën



dhe të përditshmen e tij, jashtë dyerve të teatrit. Aktori është gjithmonë në luftë me zhurmat e akrepave, orën dhe kohën si koncept, arrin të fitojë, por kthehet shumë më përpara, te momentet e lumtura të tij, i takon ata që pa dashje i kanë shkaktuar vetminë, i jeton momentet pa frikë, pa paragjykime. Në thelb shfaqja është e bazuar në personazhe të jetës reale, kryesisht mosha të treta dhe historitë e tyre konkrete, ku jeta i ka përballur me humbjen e njerëzve të dashur, vetminë, me peshën dhe rëndësinë e kohës, vlerën e saj dhe dëshirën për të jetuar ose jo.

“Zhurma e kohës” është shfaqja që çel festivalin e veprës shqipe në Teatrin Metropol, “Metrofest 6”. Një shfaqje e zhanrit të Teatrit të Lëvizjes.

“GRATË E KAZANOVËS”

Data: 6-7 dhjetor 2022

Ora: 18.00

Vendi: Teatri “Bylis”, Fier

Bileta: 300 lekë

Përkthyes: Anila Pango

Skenograf: Genc Shkodrani


Kostumograf: Joni Peçi

Indrit Çobani vjen në rolin e Xhozef Barnetit.

Një Kazanova i ri i ditëve të sotme, të cilin, krejt papritur, e kap dëshira për t’u bërë baba... Por një baba pa një grua në shtëpi ama...

Regjisore: Andia Xhunga

Indrit Çobani, Rozana Radi, Andia Xhunga



“FESTON”

Data: 3-30 dhjetor 2022

Vendi: Teatri “Andon Zako Çajupi”, Korçë

Qendra e Artit dhe Kulturës, teatri “Andon Zako Çajupi”

dhe Bashkia Korçë organizojnë një muaj të tërë aktivitetesh, titulluar “festON”. Një kalendar i pasur artistik në të cilin nuk mungojnë shfaqjet teatrale, koncertet, ekspozitat etj.

KONCERT RECITAL NGA ORKESTRA E ANSAMBLIT POPULLOR TË TKOBAP

Data: 3 dhe 4 dhjetor 2022

Ora: 19:00

Vendi: TKOBAP

Për herë të parë Orkestra e Ansambilit Popullor të TKOBAP-it vjen në një formë krejtësisht origjinale, me një koncert recital. Synimi i këtij koncerti është rritja e audiencës, e cilësisë artistike dhe teknike nëpërmjet diversitetit të zhanreve, ruajtja dhe zhvillimi i vlerave më të mira të trashëgimisë kulturore. Repertori më i spikatur i muzikës instrumentale të orkestrës së Ansambilit, ardhur në një formë krejtësisht origjinale, duke u integruar edhe me këndimin e orkestrës. Orkestra e Ansambilit do të luajë muzikën dhe njëkohësisht edhe do të këndojë në momente të veçanta. Mos humbisni përvojën e përjetimit të ri dhe ndryshe të artit tradicional, sjellë në formë unike dhe të mrekullueshme.

Biletat shiten çdo ditë pranë sportelit të TKOB në oraret 10:00- 14:00 dhe 16:00- 20:00.

Bileta kushton 800 dhe 1000 lekë.



KONCERT RECITAL I KITARISTIT INTERNACIONAL RICARDO J. MARTINC

Data: 08 dhjetor 2022

Ora: 19:00

Vendi: Holli i TKOBAP

Koncert me një program të pasur të repertorit instrumental solistik të kitaristit tepër të njohur, i cili vjen për herë të parë në Shqipëri. Aktiviteti organizohet nga Ministria e Kulturës në bashkëpunim me TKOBAP-in.

“DON PASQUALE”

OPERA-PREMIERË

Edukim Përmes Kulturës

Data: 14-18 dhjetor 2022

Ora: 11:00

Vendi: Skena e TKOBAP

Muzika: Gaetano Donizetti

Regjisor: Mariano Bauduin

Dirigjent: Simon Krecic Koncertmaester: Herta Cane, Igli Rapaj

Don Pasquale vjen në TKOBAP si një produksion i ri duke përfshirë artistët e rinj dhe ata në karrierë të teatrit. Regjia është e regjisorit të famshëm Mariano Bauduin, kurse dirigjent Simon Krecic, figurë tepër e njohur në fushën artistike. Vepra është një opera, ku bashkohet intriga dhe dashuria.

“ORATORIO DI NOEL”

KONCERT- PREMIERE

Koncert koral

Data: 23 dhjetor 2022

Ora: 19:00

Vendi: Holli i TKOBAP

Bashkëpunim me EU.

Koncert festiv me një repertor dedikuar festave të fundvitit.

Dirigjent: Dritan Lumshi

Koncertmaester: Etrita Ibrahim

“ASPETTANDO VERDI”

Grand Gala

KONCERT – PREMIERE

Data: 27 dhjetor 2022

Ora: 19:00

Vendi: Skena e TKOBAP



Bashkëpunim me EU.

Dirigjent: Jacopo Sipari di Pescasseroli

Gala me një repertor gjithëpërfshirës të krijimtarisë së kompozitorit ndër më të famshmit operistik Giuseppe Verdi.

Të gjithë solistët e TKOBAP do të interpretojnë momentet më përfaqësuese të repertorit verdian. Gjatë kësaj galaje janë të ftuar dhe dy solistë lirikë me famë ndërkombëtare.

“JESUS CHRIST SUPERSTAR”

Data: 26-30 dhjetor 2022

Ora: 19.00

Vendi: Arturbina, sala e madhe 400

Musical

Kompozitor: Andrew Weeber

Kohëzgjatja: 1 orë

“110 VJET PAVARËSI-110 VJET FORCA TË ARMATOSUR-SË BASHKU PËR PAQEN”

Koncert

Data: 3 dhjetor 2022

Vendi: Pallati i Kongreseve

Me pjesëmarrjen e mbi 300 artistëve nga Orkestra Simfonike e FA, Kori i FA, Banda e Ushtrisë shqiptare dhe bandat e ushtrive të Kosovës dhe vendeve të NATO-s nga SHBA, Britania e Madhe, Franca, Italia, Greqia, Maqedonia e Veriut, Kroacia dhe Sllovenia.



Kuarteti i muzikantëve të La Scala
Joseph Haydn - Kuarteti nr. 64 (Mishor) op. 76 nr. 3 "Kvarteti i mitorit"
Nino Rota - Kuarteti (hargah) (premiere shqiptare) Ludwig van Beethoven - Kuarteti nr. 10 minor op. 68 nr. 1

SUELA PICIRI
VIOLINE
ESTELA SHESHI
VIOLINE
ALFREDO ZAMARRA
VIOLINE
MARTINA LOPEZ
CELLO

different trains Festival 2022
E HËNË 5 DHJETOR | LICEU ARTISTIK SALLA "TONIN HARAPI" | 19:00

Ministria e Kulturës

KUARTETI I MUZIKËS SË LA SCALA-S

Koncert

Data: 5 dhjetor 2022

Ora: 19.00

Vendi: Salla e Liceut Artistik "Jordan Misja", në Tiranë

Me muzikantët Suela Piciri, Estela Sheshi, Alfredo Zamorra dhe Martina Lopez, një formacion i muzikës së dhomës së Teatrit La Scala.

Në program Haydn, Rota, Beethoven

MICHEL SETBOUN: FOTOREPORTERI NË KOHËN E DUHUR, NË VENDIN E DUHUR

Data: 25.11.2022 - 19.02.2023

Vendi: Muzeu Kombëtar i Fotografisë “Marubi”, Shkodër

Michel Setboun e vizitoi për herë të parë Shqipërinë në vitin 1981. Shkreplet e serisë ‘Shqipëria në vitin 1981’ janë të kësaj periudhe, në të cilën nuk gjejmë asnjë imazh që tregon realitetin e burgjeve, kampeve të internimit, shkatërrimin e objekteve të kultit apo skamjen ku jetonin shqiptarët. ‘Jeta në rrugë nën regjimin komunist në Shkodër’ është e vetmja foto e shkrepur tinëz, në të cilën dallohet habia që shqiptarët kishin kur shikonin të huajt.

Ardhja e Setboun-it në ‘90-n ishte e ndryshme prej kohës kur vinte i kamufeluar si turist në një vend të izoluar. Këtë herë ai shfaqet si fotoreporter në aksion që punonte për agjencitë e huaja të lajmeve të cilat donin të dokumentonin rënien e sistemit komunist. Për të kuptuar rëndësinë e tij, mjafton të kërkojmë në Google dhe të shikojmë se shkreplet e Setboun-it janë ato që fiksuan ikjen e madhe të shqiptarëve në Europë më 2 korrik 1990 - të paraqitura në serinë ‘Exodus’ - zgjedhjet e para pluraliste në serinë ‘Fillimet e demokracisë’ dhe ngjarjet e ndodhura pas Demonstratës Antikomuniste të 2 prillit 1991 në Shkodër në serinë ‘Trazirat dhe funeralet e prillit 1991’. Ekspozita është e fokusuar vetëm në rolin e Setboun-it në dokumentimin e rënies së regjimit komunist në Shqipëri e të disa ritualeve që shkrepë pas viteve ‘90.

Michel Setboun (1952, Bône, Algjeri) është një fotoreporter francez. E filloi karrierën e tij si arkitekt dhe në vitin 1978 nisi të punonte si fotoreporter lajmesh dhe lufte. Përgjatë dhjetë viteve, punoi për agjencitë Sipa dhe Black Star duke mbuluar konfliktet në Iran, El Salvador, Pakistan, Izrael e vende të tjera. Në fund të viteve 1980 iu bashkua agjencive Rapho dhe Sygma për projekte fotografike ndërkombëtare në Mongoli, Hong Kong, Shqipëri. Njihet ndërkombëtarisht si fotoreporter që fiksoi ‘Luftën për Pavarësi në Angola’ (1976), ‘Luftën Civile në Liban’ (1976), ‘Luftën Civile në El Salvador’ (1979) ku edhe mbeti i plagosur, ‘Luftën Sovjeto-Afgane’ (1979), ‘Revolucionin Islamik Iranian’ (1979), ‘Luftën Irak-Iran’ (1983), ‘Krizën nigeriane të refugjatëve’ (1982) me të cilën fitoi çmimin e parë të World Press Photo dhe ‘Sulmin e kullave binjake në New York’ (2001). Në 1990 vendosi të punojë si fotograf i pavarur. Krahas angazhimit si fotoreporter, realizon edhe fotografi artistike dhe libra fotografikë.

Punët e tij janë publikuar në revista e gazeta të rëndësishme mes të cilave The New York Times, Géo, Life, Paris Match. Ekspozita mbështetet nga Ministria e Kulturës dhe Ambasada e Francës në Shqipëri.



EKSPOZITË FOTOGRAFIKE

Roland Tasho

Data: 4 dhjetor 2022

Vendi: Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit

Ekspozita fotografike me portrete të shkrimtarëve shqiptarë, realizuar nga fotografi Roland Tasho, vjen këtë herë në ambientet e QKLL-së. Në një karrige, që e ka quajtur “karrigia e shkrimtarëve”, Tasho ka ulur për të pozuar shkrimtarët më të mëdhenj shqiptarë, që nga Kadare te Agolli e me radhë.

“UDHA DREJT PAVARËSISË”

Ekspozitë

Data: 1-7 dhjetor 2022

Vendi: Salla e ekspozitave në katin e dytë të Muzeut Historik Kombëtar

Në kuadër të festave të nëntorit Muzeu Historik Kombëtar ka hapur ekspozitën “Udha drejt Pavarësisë”, në të cilën përshkruhet udha e mundimshme e firmëtarëve të aktit të Pavarësisë së Shqipërisë, si dhe artefakte të tyre.

“RRUGËTIMI I SHQIPËRISË NË KOMUNIZËM”

Ekspozitë me rastin e ditës së Çlirimit

Data: 1- 7 dhjetor 2022

Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me gjethe”

“CAN FOR BALKANS”

Ekspozitë ndërkombëtare

Data: 1-18 dhjetor 2022

Vendi: Muzeu Historik Kombëtar, Holli kryesor

Ekspozita është pjesë e projektit “CAN for Balkans” – Comics Alliance Networking for Balkans”, financuar nga Programi i Financimit të Europës Krijuese. Qëllimi i këtij projekti është krijimi i një rrjeti kulturor ndërkufitar për të lehtësuar bashkëpunimin midis artistëve dhe specialistëve në botën e novelave grafike në Ballkanin Perëndimor dhe Bashkimin Europian, në frymën e vlerave të Bashkimit Europian. Muzeu Historik Kombëtar, si partneri nr. 2 në këtë projekt, ka rol zbatues në menazhimin dhe organizimin e aktiviteteve në kuadër të realizimit të projektit.

“SALLONI I VJESHTËS” 2022

Edicioni i 16-të i Ekspozitës Kombëtare

Data: 1 dhjetor 2022- 22 janar 2023

Vendi: Galeria e Arteve, Shkodër

Artistët pjesëmarrës:



Abaz Hado / Admir Pervathi / Adnan Bushati / Agron Hoti / Aleksander Hila / Alfred Mirashi Milot / Anastas Kostandini - Taso / Andi Hila / Anila Hetoja / Anton Krasniqi / Arben Dreshaj / Arben Suma / Arbnor Morina / Artan Dracini / Art Izri / Blegina Bezo / Bujar Zajmi / Caush Vathi / Denisa Brahimi / Driton Hajredini / Edison Shahini / Elio Bajramaj Art / Elisa Koçeku / Erëmirë Jahja / Eris Bushati / Erjon Nazeraaj / Fatmir Juka / Fehmi Hoxha / Galeriartigpriftuli Durres / Gazmend Leka / Genti Tavanxhiu / Greta Tahiraga / Hajdar Danjollu / Helidon Doni Haliti / Hysni Loka / Jetmira Kraja / Kaltrina Hoda / Liliana Çefa / Lindita Dedukaj / Meri File / Mervan Mustafa / Mjellma Goranci Firzi / Moikom Zeqo / Monika Dukaj / Nikolett Vasja / Nirvana Baja / Ols Plasa / Pashk Përvathi / Qazim Xhyllani / Refki Golloperi / Rubin Mandija / Sabri Behramaj / Senad Xhexhovi / Shpresa Beqiri / Shqipe Kamberi / Sidrit Lohja / Sokol Kola / Umberto Pali / Valbona Kapllani / Xheneta Kadillari / Zana Ramadani.

“TINGUJ TË HESHTUR: INSTRUMENTE MUZIKORE TË TIRANËS SIPAS ARKIVIT ETNOGRAFIK”

Ekspozitë

Data: 7 dhjetor 2022

Ora: 11:00

Vendi: Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe i Studimit të Artit

Instrumentet muzikore që janë përdorur në Shqipëri, kryesisht në kuadrin e praktikave tradicionale përbëjnë një koleksion të pasur në arkivin etnografik të Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe i Studimit të Artit, të cilat do të ekspozohen në një seri ekspozitash.

Janë vegla muzikore të 4 kategorive: aerofone, membranofone, vegla idiofone dhe ato kordofone. Jemi në një proces i cili rrëfen larminë e tyre, si dëshmi e fazave në të cilat ka kaluar muzikëbërja: nga format më parake, të natyrës rituale e të zonave rurale, te reper-torët më të konsoliduar brenda ansambleve të muzikës urbane dhe argëtimit. Vend zënë gjithashtu edhe instrumente që janë përdorur brenda praktikave fetare, siç janë ato të bektashinjve dhe helvetvie. Ndërsa disa instrumente vazhdojnë ende të bëjnë një jetë aktive, disa të tjera kanë dalë nga përdorimi. Ky fakt e bën edhe më interesante këtë ekspozitë.



“EDHE UNË MUNDEM”

Data: 2 dhjetor 2022

Ora: 11:00.

Vendi: Muzeu Historik Kombëtar, kati i dytë, Pavijoni i mesjetës shqiptare.

Në kuadër të datës 3 dhjetor, Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara, Muzeu Historik Kombëtar në bashkëpunim me Institutin e Nxënësve që nuk Shikojnë, organizon aktivitetin me titull “Edhe unë mundem!”.

Personat me aftësi të kufizuara kanë të njëjtat të drejta themelore si bashkëqytetarët e tyre të së njëjtës moshë, që nënkupton para së gjithash të drejtën për të jetuar një jetë të denjë, sa më normale dhe të plotë që të jetë e mundur.

Bashkëpunimet midis Muzeu Historik Kombëtar me Institutin e Nxënësve që nuk Shikojnë kanë si objekt integrimin në shoqëri të fëmijëve me aftësi ndryshe. Ky bashkëpunim ka për qëllim të mbështesë personat me aftësi të kufizuara për të pasur akses në të gjitha sferat e jetës, si në qendrat kulturore, ashtu dhe në qendra të tjera publike.

Aktiviteti do të organizohet në dy sesione me gjimnazistë dhe nxënësit e Institutit Kombëtar. Gjimnazistët do të prezantojnë veshjet kombëtare të krahinave të ndryshme të Shqipërisë. Nxënësit e shkollës 9-vjeçare do të luajnë ashtu siç luajnë edhe fëmijët nëpër botë. Ata do të luajnë lojën “Mos u nxeh”, lojë e mundësuar nga organizata joqeveritare “Trashëgimi Kulturor pa Kufij”. Nëpërmjet lojës “Mos u nxeh” fëmijët njihen me trashëgiminë e qyteteve të qyteteve të veçanta; ata do të mësojnë duke luajtur.

“MBRESA”

Data: 02 dhjetor 2022

Ora: 12:00

Vendi:

Me pjesëmarrjen e nxënësve të shkollës “Eqrem Çabej”

Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me gjethe” vijon me programin e përmuajshëm edukativ “Mbresa”, me pjesëmarrjen e nxënësve të shkollave të mesme.

Gjatë këtij takimi, të rinjtë njihen me një pjesë të historisë së errët të komunizmit në Shqipëri. Përgjatë këtij muaji do të zhvillohen takime me nxënës të shkollave “Eqrem Çabej”.

“KUJTOJMË PËR TË MOS HARRUAR”

Data: 09 dhjetor 2022

Ora: 12:00

Me pjesëmarrjen e nxënësve të shkollës “Kongresi i Manastirit”

Data: 15 dhjetor 2022

Ora: 12:00

Me pjesëmarrjen e nxënësve të shkollës “At Zef Pllumi”



Data: 22 dhjetor 2022

Ora: 11:00

Me pjesëmarrjen e nxënësve të shkollës “Drita Pelingu” Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me gjethe” vijon me programin e përmuajshëm edukativ me pjesëmarrjen e nxënësve të shkollave të mesme. Gjatë këtij takimi të rinjtë njihen me një pjesë të historisë së errët të komunizmit në Shqipëri. Përgjatë këtij muaji do të zhvillohen takime me nxënës të shkollave “Kongresi i Manastirit”, “At Zef Pllumi” dhe “Drita Pelingu”, Tiranë.

“PËRBALLJE ME TË KALUARËN

Tryezë e rrumbullakët

Data: 8 dhjetor 2022

Ora: 11:00

Vendi: Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me Gjethe” Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me Gjethe” në bashkëpunim me Fakultetin Histori- Filologji, Departamenti i Historisë organizojnë takim me studentët e Departamentit të Historisë, në kuadër të Ditës Kombëtare të Rinisë, të shoqëruar nga prof. Enriketa Pandejmoni (Papa)

“NDARJA E ÇMIMEVE TË KONKURSIONIT TË PIKTURËS BITOLA 2022”

Ekspozitë pikturë

Data: 16 dhjetor 2022

Ora: 17:00

Vendi: Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë

“NA ISHTE NJËHERË”

Shfaqje teatrale për fëmijë

Data: 3-4 dhjetor 2022

Ora: 10:30; 11:30

Vendi: Salla “Tonin Harapi”, Liceu artistik “Jordan Misja”, Tiranë

SHOW ME KUKULLA

Data: 4 dhjetor 2022

Ora: 10:30

Vendi: Teatri “Skampa”, Elbasan

Me moton “Edukojmë nëpërmjet argëtimit”, Teatri “Skampa” prezanton një premierë shumë të bukur interaktive për fëmijë, ku spektatorët e vegjël bëhen pjesë e shfaqjes, duke komunikuar e ndërvepruar me personazhet. Biletat do të shiten para shfaqjes, në sportelin e teatrit.



“ZONJUSHË PLASTIKA”

Shfaqje teatrale për fëmijë

Data: 10, 11, 17, 18, 24, 25 dhjetor 2022

Ora: 10:30; 11:30

Vendi: Salla “Tonin Harapi”, Liceu artistik “Jordan Misja”, Tiranë

Regjia: Anderson Gurra

Interpretojnë fëmijët e kursit të aktrimit të QKKF dhe aktorët e Teatrit të Kukullave
Esmeralda Kame, Jorida Meta, Madi Selimi, Elidon Alike.

Kohëzgjatja 35 minuta

SHFAQJA “TRE DERRKUCËT”

Shfaqje teatrale me kukulla

Data: 31 dhjetor 2022

Ora: 10:30 dhe 11:30

Vendi: Salla “Tonin Harapi”, Liceu artistik “Jordan Misja”

Një nga përrallat më të dashura për fëmijë vjen nën interpretimin e artistëve të Teatrit të Kukullave.

Regjia: Paolo Comentale

Aktorët: Elidon Alike, Jorida Meta, Ermonela Alikaj, Aleksandër Grami, Madi Selimi, Flori Kokona.

Kohëzgjatja: 35 minuta



“STUDIME MUZEOLOGJIKE”

Promovim

Data: 22 dhjetor 2022

Ora: 11:00

Vendi: Salla “Kostandin Shpataku”, Muzeu Historik Kombëtar

Muzeu Historik Kombëtar organizon promovimin e revistës “Studime Muzeologjike”, Nr. 13, që i kushtohen konferencës shkencore me temë: “Noli Poliedrik”

FESTIVALI I PERFORMANCËS LETRARE

Data: 1 dhjetor 2022

Ora: 12:00

Vendi: salla “Liria”, Qyteti Studenti

“Festivali i Performancës Letrare” është aktiviteti përmbyllës i ciklit prej katër aktivitetesh, konceptuar në projektin “Brikolazh dhe projeksione letrare”, të mbështetur nga Ministria e Kulturës.

“PARADIGMA E PARAJSËS”

Data: 2 dhjetor 2022

Ora: 16:30

Vendi: Salla e Teatrit Eksperimental Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës, organizojnë më 2 dhjetor 2022, ora 16:30, promovimin e vëllimit poetik «Paradigma e parajsës» nga poeti Gjekë Marinaj.


“DRITËHIJE”

Promovimi i Revistës Muzeologjike

Data: 14 dhjetor 2022

Ora: 11:00

Vendi: Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me Gjethe”





"TIRANA GATE 2022"

Festivali letrar i të rinjve, seksioni II, edicioni VIII

CEREMONIA FINALE

Data: 4 dhjetor 2022

Ora: 11:00

Vendi: Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit

"70-VJETORI I LINDJES SË SHKRIMTARIT VISAR ZHITI"

Ekspozitë mbi veprën e shkrimtarit

Data: 2 dhjetor

Vendi: Biblioteka Kombëtare, në Hollin e Katit II
Në ambientet e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, nesër në orën 11:00, në praninë edhe të autorit, ekspozitë e veprave dhe krijimtarisë së tij, nga poezia e parë e vitit 1969 deri në romanin e fundit "Këpuca e aktorit". Një ekspozitë që hapet me rastin e 70-vjetorit të lindjes së shkrimtarit dhe poetit.
Krahas krijimtarisë letrare, në këtë ekspozitë janë përfshirë edhe botimet në gjuhë të huaj të veprës së shkrimtarit, si dhe kontributi i tij i vyer si përkthyes.



AKTIVITET KUSHTUAR PJETËR BUDIT

Data: 12 dhjetor 2022

Ora: 12:00

Vendi: Salla "Kostandin Shpataraku"

I ftuar studiuesi Behar Gjoka

Muzeu Historik Kombëtar dhe Qendra Shqiptare e Studimeve Letrare "Pjetër Budi" organizojnë aktivitetin kushtuar njërit prej patriarkëve të gjuhës dhe letrave shqipe, Pjetër Budi.

MBRËMJE POETIKE, KUSHTUAR POETIT LASGUSH PORADECI

Data: 27 dhjetor 2022

Ora: 18:00

Vendi: Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit

“NJË FILXHAN KAFE DHE KËPUCË TË REJA VESHUR”

vazhdon të shfaqet në Cineplexx TEG dhe në
kinema “Millennium”

deri në datën 7 dhjetor.

Cineplexx:

<https://www.cineplexx.al/.../A-Cup-Of-Coffee-And-New.../>

Millennium: <https://www.kinemamillennium.com/index.php?p=film&info=12350>

Një film nga Gentian Koçi,

Me mbështetje financiare nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë (QKK), Portuguese Cinema and Audiovisual Institute (ICA), Eurimages - Council of Europe, Media - Creative Europe, Hellenic Broadcasting Corporation (ERT), Qendra Kinematografike e Kosovës (QKK), RTSH- Radio-Televizioni Shqiptar, Greek Film Centre, Bashkia e Tiranës.

